




<b>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br.Prot.
Nr. I faq.	Prot No. 01-395/14
Broj stranica	Data
Nr. pages	Datum 31.01.2014
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	31.01.2014
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPKPP
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Elmaze XHEMA Menaxhere e Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Financave
<b>CC:</b>	z. Naim BAFTIU Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit <i>H. Preteni</i>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me tenderin me titull "Shërbime për larjen e automjeteve të Ministrisë së Financave"



E nderauara znj. Xhemë,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Shërbime për larjen e automjeteve të Ministrisë së Financave"- Ri-tender me nr. prokurimi 2011407236, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

### OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejmë A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitim e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Shërbime për larjen e automjeteve të Ministrisë së Financave" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Ministrinë e Financave ka përgatitë “ Njoftimin për Kontratë ” me titull “Shërbime për larjen e automjeteve të Ministrisë së Financave”- Ri-tender me nr. prokurimi 2011407236, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 24.01.2014, në Procedurën e Kuotimit të Çmimeve. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të këtij aktiviteti të prokurimit në “Dosjen e tenderit”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Dosjen e tenderit” që ka përgatitur A.K. tek pika III.1 e rubrikës “Kërkesat e përshtatshmërisë”, pika 5. është kërkuar që lartësia e autolarjes nuk bënë me qenë më larg se 3 km nga Qendra e MF-ve (për arsyet e mos shpenzimeve të automjeteve, mos të ketë largësi rrugore), pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues Ministria e Financave me formulimin e këtij kriteri tek ”Kërkesat e përshtatshmërisë” pika 5. e “Dosjes së Tenderit”, ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se “Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrëthanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik ”. Kufizimi që OE duhet të jetë më afër se 3 km nga MF, diskriminon OE që janë në largësi më të madhe dhe favorizon ata OE që janë nën 3 km..

Kriteret e lartë cekura në pikën III.1 e rubrikës “Kërkesat e përshtatshmërisë”, siç janë pëershkruar në ”Dosjen e Tenderit”, bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi janë kritere diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë duke favorizuar Operatorët e caktuar Ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me, nenin 7 Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shhangen praktika të tillë në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

